

URDHËR
Nr.1, datë 5.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, z.Kujtim Osmani.
2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Gjykatës Kushtetuese, do të ushtrohen për periudhën 5.1.2015, deri më 31.12.2015.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I GJYKATËS KUSHTETUESE
Bashkim Dedja